



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETAR

Nr. 15960 Prot

Shkodër, më 26.07.2024

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendimi dhe relacioni

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar Këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim relacion dhe projekt-vendim:

PËR

**“ STREHIMIN EMERGJENT TË ZJ. XH. B DHE FËMIJËVE TË MITUR NË NJËSITË
E BANIMIT TEK BANESAT SOCIALE ME QIRA PRANË QENDRËS KOMUNITARE
“PËR FAMILJEN” NR. 6 (ISH-KONVIKTI I SHKOLLËS PYJORE)”**

Duke Ju uruar punë të mbarë!

Me respekt,

KRYETAR

Benet BECI

**ME VENDIM DELEGIM
ZV. KRYETAR
Onid BEJLERI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2024

PROJEKT – VENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ .2024

PËR

“PËR STREHIMIN EMERGJENT TË ZJ. XH. B DHE FËMIJËVE TË MITUR NË NJËSITË E BANIMIT TEK BANESAT SOCIALE ME QIRA PRANË QENDRËS KOMUNITARE “PËR FAMILJEN” NR. 6 (ISH-KONVIKTI I SHKOLLËS PYJORE)”

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ .2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 24 pika 2, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; nenit 2, pika 25 të ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social“, i ndryshuar; pikës 19 të VKM - së nr.384 datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore; VKB nr.27 datë 26.06.2022 “Për miratimin e Rregullores për administrimin dhe mirëmbajtjen e Banesave Sociale me qira pranë Qendrës Komunitare “Për Familjen” nr.6; VKB nr.21 datë 29.04.2024 “Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira në administrimin e Bashkisë Shkodër”; Vendimit nr.174 (3548), datë 24.07.2024 “Për Lëshimin e Urdhërit të Mbrojtjes”, së Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, Relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër me nr. ____ prot, datë _____,

VENDOSI:

1. Të miratojë strehimin emergjent të Zj.Xh.B në njësitë e banimit tek Banesat Sociale me qira pranë Qendrës Komunitare “Për Familjen” nr.6(Ish-Konvikti i Shkollës Pyjore).
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Shkodër.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Benet BECI

**ME VENDIM DELEGIMI
ZV/KRYETAR
Onid BEJLERI**

Zv/Kryetar



Drejtoria e Përgjithshme Sociale dhe Rinisë

Edlita Shoshi Shoshi

Drejtoria e Shërbimeve Sociale

A. Krysi

Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Burimeve Njerëzore
dhe Shërbimeve Mbështetëse

Denis Dusha

Drejtoria Juridike

Marjela Fushkaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME SOCIALE DHE RINISË
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Nr. _____ Prot.

Shkodër, më ____ . ____ .2024

RELACION

“PËR STREHIMIN EMERGJENT TË ZJ. XH. B DHE FËMIJËVE TË MITUR NË NJËSITË E BANIMIT TEK BANESAT SOCIALE ME QIRA PRANË QENDRËS KOMUNITARE “PËR FAMILJEN” NR. 6 (ISH-KONVIKTI I SHKOLLËS PYJORE)”

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar Këshilltarë,

Me datë 24.07.2024, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër me vendimin 174 (3548) datë 24.07.2024 “Për Lëshimin e Urdhërit të Mbrojtjes”, në paragrafin 5 të pikës 1 të dispozitivit, ka vendosur:

- Vendosjen e menjëhershme të paditëses Xh.B (së bashku me fëmijët e saj të mitur), në strehim të përkohshëm, duke mbajtur parasysh edhe interesin më të lartë të të miturve dhe shprehjes së dakortësisë së saj, në banesën sociale të Bashkisë Shkodër, pranë ish Konviktit të Shkollës Pyjore, Shkodër.

Nga sa më sipër, në zbatim të pikës 19 të VKM nr. 384 datë 12.06.2019 “Për caktimin e dokumentacionit për të përfitur sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, në të gjitha situatat e gjendjes së emergjencës, kur procedura fillon me kërkesë të individit/familjes përfituese, ose kryesisht nga vetë njësia e vetëqeverisjes vendore, emri/at/ lista e aplikantëve paraqitet/n menjëherë në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore për miratim.

Duke qenë në kushtet e nevojës emergjente për strehim, propozojmë të miratohet në Këshillin Bashkiak strehimi emergjent i zj.Xh.B me fëmijët e saj, në njësitë e banimit tek Banesat Sociale me qira pranë Qendrës Komunitare “Për Familjen” nr.6 (ish-Konvikti i Shkollës Pyjore) në njësinë e banimit me nr.17.

Rasti i Xh.Bajrami është referuar nga Alo 116 111 - Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë, kemi komunikuar me Zj.Xh.B e cila është pritur në ambientet e Bashkisë Shkodër nga Specialistja e Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijës, për të realizuar vlerësimin fillestar me qëllim identifikimin e nevojave primare dhe mbështetjen me shërbime. Ajo është paraqitur e qetë në takim dhe e qartë në kërkesat e parashtruara.

Zj. Xh.B është shprehur se me datën 10.07.2024 është rikthyer në Shkodër duke jetuar në banesën e familjes së saj. Banesa e familjes së saj është banesë private ku jetojnë Z.B.B, (Babai), Zj.M.B (nëna), dhe dy motrat e saj J.B dhe D.B.

Ajo ka qënë e pajisur me Urdhër Mbrojtje ndaj bashkëshortit të saj, shtetasit A.I me afat 6 mujor (UM fillon efektet më datë 20.12.2023 dhe i përfundon efektet më datë 20.06.2024), Urdher i lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, nr. vendimi 190, datë 20.12.2023.

Zonja shprehet se pas përfundimit të UM është larguar nga Qendra Kombëtare e Viktimave të Dhunës në Familje dhe ka qëndruar rrugëve të Kamzës, kjo për shkak të konflikteve që ka patur me familjen e saj në Shkodër. Ajo është shprehur se momentalisht situata është më e qetë por shpesh ka nevojë të jetojë në një banesë e vetme me fëmijët dhe të fillojë një jetë të re.

Gjatë takimit ajo është shprehur se fëmijët kanë patur kontakte periodike me babain e tyre i cili iu ka dhuruar para sipas detyrimit rreth 30–50 mijë lekë të vjetra por jo në mënyrë sistematike. Ajo shprehet se momentalisht nuk ndjehet e kërcënuar nga bashkëshorti pasi ka paraqitur dhe kërkesën për divorc kundrejt tij.

Në kuadër të menaxhimit të rastit, janë kryer hapat e mëposhtëm nga Bashkia Shkodër, Drejtoria e Shërbimeve Sociale:

- Vlerësim fillestar, përgatitje e PIM dhe vlerësim i nevojave të familjes dhe të miturve;
- Informim mbi shërbimet që mund të përfitojë pranë Bashkisë Shkodër;
- Referim për aplikim tek programet e strehimit pranë Bashkisë Shkodër;
- Referuar dhe mbështetur me dt.12.07.2024 nga organizata “Shpresë për Botën” me pako ushqimore dhe higjieno sanitare;
- Referim pranë organizatës partnere “Të ndryshëm të Barabartë” për mbështetje me qera banesa deri sa të finalizohen procedurat pranë programeve të strehimit, shërbimet këshillim psikologjik për Zj. Xh.B dhe fëmijët e mitur, mbështetje juridike dhe lehtësim për procedurat e divorcit, mbështetje me kurse profesionale;
- Sigurim i punësimit në një prej bizneseve i lehtësuar nga Qendra komunitare “Për familjen” nr.4 e cila do ndjekë rastin në vazhdimësi për ecurinë e saj;
- Referuar pranë organizatës “SOS- Fshatrat e fëmijëve” për shërbimet mbështetje me kopësht, cerdhe për fëmijët e mitur, përfshirje në aktivitete verore me fëmijët, rritje e kapacitetit prindëror të nënës nëpërmjet programeve të prindërimit;

- Referuar për veshje pranë organizatës “Shpresë për Botën”;

Sipas raportimit mediatik, ditën e mërkure me datë 17.07.2024, Zj. Xh.B ka dërguar një mesazh tek të afërm të saj duke deklaruar se është larguar nga banesa. Nëna e saj pas komunikimit me të, ka njoftuar babain e Zj.Xh.B që vajza e tyre është larguar.

Ky i fundit menjëherë ka njoftuar Policinë e Shtetit duke kërkuar ndihmë për sigurinë e saj.

Stafi i Shërbimit Social i Bashkisë Shkodër (PMF) pas njoftimit nga policia ka marrë pjesë në intervistimin e Zj. Xh.B si dhe sistemimin e tyre në një ambient të sigurtë, përkatësisht në strehën emergjente. Zj.Xh.B në ambientet e policisë është pajisur me UMM ndaj babait të saj. Seanca për vertetimin e UMM u la për ditën e hënë, datë 22.07.2024 ora 11:30.

Me datë 18.07.2024 është realizuar një takim me bashkëshortin Z. A. I i cili është paraqitur në ambientet e Bashkisë Shkodër me shqetësimin se nuk kishte informacion se ku ndodhej bashkëshortja e tij dhe fëmijët e mitur. Gjatë takimit, ai ka shprehur gatishmërinë për mbështetjen e Znj. Xh.B dhe të miturve. Gjithashtu ai ka kërkuar të takojë të miturit pasi është i shqetësuar për gjendjen e tyre.

Me datë 18.07.2024, Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve ka realizuar një mbledhje të Grupit Teknik Ndërsektorial (GTN), ku çështjet kryesore të diskutuara në GTN ishin si më poshte:

- Realizimin e një vlerësimi të thelluar për gjendjen psikologjike të Znj. Xh.B dhe të miturve dhe problemet e shëndetit mendor. (Kjo pikë u dakortësua nga gjithë anëtarët e GTN)
- Marrja e masës vendosje në Institucionin e Përkujdesit Social, “Shtëpia e fëmijës” sipas grupmoshave. (Kjo pikë u dakortësua nga një pjesë e grupit pasi pjesa tjetër e mendon si alternative të fundit)
- Sistemimi i Znj. Xh.B dhe të miturve në Strehën Papa Xhovani XXIII (Edhe ky variant do të diskutohet pas vlerësimit të psikiatrit)
- Vlerësimi i thelluar i babait dhe familjes së tij.
- Mbështetja nga organizatat partnere si: “Të Ndryshëm të Barabartë”, “SOS - Fshatrat e fëmijëve”, “Shpresë për Botën”, “Nisma për Ndryshim Shoqëror, ARSIS”, “Hapa të Lehtë” dhe “Gruaja tek Gruaja” për të gjitha shërbimet që ato ofrojnë.

Në fund të mbledhjes së GTN-së mes anëtarëve u ra dakort që Znj. Xh.B , së bashku me fëmijët, do të realizojë vlerësimin e shëndetit mendor duke u lehtësuar nga QKSHM dhe Qendra e Emergjencës me datë 19.07.2024 ora 10:00.

Deri në marrjen e masës mbrojtëse zj. Xh.B dhe femijët do të qëndronin në strehëzen emergjente. Me datë 19.07.2024 u realizuan vizitat nga komisioni mjeksor i Qendrës Komunitare të Shëndetit Mendor, për nënën dhe të miturit, konkretisht për Zj. Xh.B u konstatua “Pa probleme akute të shëndetit mendor”.

Me datë 22.07.2024 u bë takimi i rradhës i mbledhjes së Grupit Teknik Ndërsektorial (GTN) duke patur në fokus interesin me të lartë të fëmijëve të mitur.

Nga kjo mbledhje u dakortësua:

- Marrja e masës së mbikëqyrjes së specializuar në mjedisin familjar, për një periudhë kohore 6- mujore, kohë e cila do monitorohet për dinamikat që do paraqesë rasti.
- Sigurimi i një strehimit emergjent pas daljes nga streha.
- Integrimi i fëmijëve në çerdhe dhe kopësht me drekë .

Duke qenë në kushtet e nevojës emergjente për strehim, propozojmë të miratohet në Këshillin Bashkiak strehimi emergjent i zj.Xh.B me fëmijët e saj, në njësitë e banimit tek Banesat Sociale me qira pranë Qendrës Komunitare “Për Familjen”, nr.6 (ish-konvikti i shkollës Pyjore) në njësinë e banimit me nr.17.

Ju ftojme të miratoni projekt-vendimin “Për strehimin emergjent të zj. Xh.B dhe fëmijëve të mitur në njësitë e banimit tek banesat sociale me qira pranë Qendrës Komunitare “Për familjen” nr. 6 (ish-konvikti i Shkollës Pyjore)”.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!

ME VENDIM DELEGIMI
ZV/KRYETAR
Onid Bejleri



Drejtorja e Përgjithshme Sociale dhe Rinisë

Edita SHOSHI

Drejtorja e Shërbimeve Sociale

Arlinda KRUJA

KRYETAR
Benet BECI